



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2673, datë 07.04.2016

për

Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO-së dhe Njoftimin e Fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160 - 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz”, Ref.2-2x5+5-2016.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Sara Reçi, në mbledhjen e datës 07.04.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimi i Raportit Përmbledhës të KVO-së dhe Njoftimin e Fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz”, Ref.2-2x5+5-2016.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

2. VKM Nr. 1252, datë 10.09.2008 pika 19.1 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
3. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor mbi çështjen, paraqitur nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve si më poshtë:

- Raporti përmbledhës i procedurës së tenderit publik protokolluar me Nr. 365/10, datë 21.03.2016.
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Njoftimi i Fituesit sipas Shtojcës 18-Formulari i Njoftimit të Fituesit;
- Shtojca 19- Formulari i Botimit të Fituesit;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe

duke arsyetuar në mbështetje të bazës ligjore referuese,

V Ë R E N s e:

1. Dokumentacioni:

- a) **Raporti përmbledhës** i hartuar nga KVO është në përputhje me pikën 15.10, Kreu III të VKM Nr.1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
- b) **Shtojca 18- Formulari i Njoftimit të Fituesit** të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz*”, Ref.2-2x5+5-2016, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
- c) **Shtojca 19- Formulari i Botimit të Fituesit** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës dhe me Dokumentin e Tenderit.

Praktika dokumentare për shqyrtim të çështjes sipas objektit është paraqitur nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 12 të Rregullores së Brendshme të AKEP.

Dokumentacioni për miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO-së dhe Njoftimin e Fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1970 – 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz*”, Ref.2-2x5+5-2016 është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- VKM Nr. 1252, datë 10.09.2008 pika 1.3, “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
- Dokumentin e Tenderit;
- Raportin Përmbledhës të procedurës së tenderit publik protokolluar me Nr. 365/10, datë 21.03.2016,

dhe në zbatim të nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918:

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin Përmbledhës të KVO-së me Nr. 365/10 Prot., datë 21.03.2016;
2. Të miratojë Njoftimin e Fituesve, sipas dokumenteve bashkëlidhur;
3. Ti dërgohet njoftimi fituesit dhe të bëhet publikimi i njoftimit të fituesit në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____